



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:278755

Datë: 12.06.2020

Numri i dokumentit: 00960622

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 1/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarëve **A.D** nga Prizreni me mbrojtësin e tij **av.A.B nga Prizreni, dhe I.D nga Prizreni,** për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.2 te KP-esdhe vepra penale kanosje nga neni 181 par.4 te KP-es, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.2683-10/19 të datës 31.12.2019, pas mbajtjes së seancës gjyqësore fillestare publike, në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Milot Krasniqi, të akuzuarëve me datë **10.06.2020,** morri dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

Te akuzuarit

1.A.D, nga i ati B., e ëma S., i lindur më datë në Prizren, tani me banim ne fsh..... – Prizren, ne rr..... pnr, ka të kryer shkollen e mesme, i pa pune, i pamartuar, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.I.D, nga i ati B., e ëma S., i lindur më datë në Prizren, tani me banim ne fsh.... – Prizren, ne rr..... pnr, ka te kryer shkollen e mesme, i pa pune, i pamartuar, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I akuzuari **A.D**

1.Me dt.22.11.2019 rreth ores 19,30 min, ne Prizren, ne rr..... saktesisht ne palestren e fitnesit "...", i pandehuri A.D ne shoqerin e vellaut te tije te pandehurit I.D, shkojne ne objektin e palestres me qellim per te kryer stervitjen fizike dhe pas nje mosmarreveshje filimisht verbale qe kishte lindur ne lidhje me pagesen e fitnesit, duke mos gjetur rruge tjeter te adresimit te kesaj çeshtje, pasi fjalosen me menaxherin e fitnesit te demtuarin B.Sh nga Prizreni, fillimisht i pandehuri A.D e godet me grusht ne fytyre te demtuarin, e me pas hyjne ne pjesen e arkës ku qendronte i demtuari dhe duke perdor nje tube çelesash te vendosur ne doren e djathte, e sulmon fizikisht te demtuarin duke e goditur disa here ne koke, ku si pasoje e goditjeve me kete mjet te forte i demtuari peson plage shpuese ne regjionin e djathte muror te kokës dhe ne regjionin zverkor, gervishje ne fytyre, gjakmbledhje nenlekurore ne koke, ndrydhje te indeve te buta ne gjoks, te cilat paraqesin lendime te lehta trupore me pasoja per shendetin,

-kësodore kryen veprën penale lendimi i lehte trupor nga neni 185 par.2 te KP-es,]

I akuzuari I.D

2.Me dt.22.12.2019, rreth ores 19,30 min, ne Prizren, ne rr..... saktesisht ne palestren e fitnesit "...", i pandehuri I.D ne shoqerin e vellaut te tije te pandehurit A.D, shkojne ne objektin e palestres me qellim per te kryer stervitjen fizike dhe pas nje mosmarreveshje filimisht verbale qe kishte lindur ne lidhje me pagesen e fitnesit, duke mos gjetur rruge tjeter te adresimit te kesaj çeshtje, pasi fjalosen me menaxherin e fitnesit te demtuarin B.Sh nga Prizreni, dhe pasi qe i pandehuri A.D fillon te perleshet fizikisht me te demtuarin B.Sh, i pandehuri I.D nxjerr nga xhepi nje thike dhe me te e kanos seriozisht te demtuarin D.P, duke ia drejtuar thiken ne momentin kurr i demtuari tenton qe te afrohet dhe ti ndaj palet, si dhe duke krijuar mburoje dhe hapësire veprimi edhe te pandehurit A.D,

-kësodore kryen veprën penale kanosje nga neni 185 par.4 të KP-së,

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 44, 69, 70, 71, e 72, te KP-se, dhe neni 365 te KPP-es te akuzuarëve iu shqipton:

Te akuzuarit **A.D,**

DENIM ME BURG

Ne kohezgjatje prej **6 /gjashte/ muajve.**

Duke aplikuar nenin 3 par.2 te KP-se, ne baze te nenit 44 te KP-se, me pelqimin e te akuzuarëve A.D dhe mbrojtësit te tije av.A.B, denimi i shqiptuar me burgim ne kohezgjatje prej 6 /gjashte/ muajve, zevendësohet me denim me gjobe ne shumen prej **1.200,00 eurove**, ne te cilin denim me gjobe do te llogaritet edhe koha e kaluar ne arrestin shtepiak nga dt.26.11.2019 e deri me dt.25.12.2019, i akuzuari eshte i obliguar te paguaje ne afatin ligjor prej 15 diteve pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk deshiron apo

nuk do të mund të paguaje denimin me gjobe, i njëjti denim me gjobe do të zevendsohet me denim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro 1 ditë burgim.

Te akuzuarit **I.D**,

DENIM ME BURG

Ne kohezgjatje prej **6 /gjashte/ muajve**.

Duke aplikuar nenin 3 par.2 të KP-se, në bazë të nenit 44 të KP-se, me pelqimin e te akuzuarit I.D, denimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashte/ muajve, zevendësohet me denim me gjobe në shumën prej **1.200,00 eurove**, në të cilin denim me gjobe do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtepiak nga dt.26.11.2019 e deri me dt.25.12.2019, denimin me gjobe i akuzuari është i obliguar të paguaje në afatin ligjor prej 15 ditëve pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk do të mund të paguaje denimin me gjobe, i njëjti denim me gjobe do të zevendsohet me denim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro 1 ditë burgim.

Konform nenit 115 të KPP-es, gjykata të akuzuarit I.D krahas denimit kryesor i shqipton edhe denimin plotësues dhe atë: në emër të ..., i konfiskohet një thike me dorëz të zeze.

Te akuzuarit obligohen që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogaritjes së gjykates, në emër të shpenzimeve të paushalit gjyqësor shumën secili veç e veç me nga **50,00 Euro**, në emër të kompenzimit të viktimave të krimit shumën secili veç e veç me nga **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kercnim të ekzekutimit të dhunshëm.

Te demtuarit B.(S).Sh nga Prizreni rr..... nr....., me përfaqësuesin e tij av.M.Q nga Prizreni rr.....nr....., dhe D.(E).Pnga Prizreni rr.... nr....., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën me PP. nr.2683-10/2019 të dt.31.12.2019, kundër të akuzuarëve **A. e I.D që të dy nga Prizreni**, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.,2 të KP-es e vepra penale kanosje nga neni 181 par.4 të KP-es,

Gjykata ne shqyrtim gjyqesor fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesis nga ana e te akuzareve te cilet vullnetarisht e kane pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se te akuzuarit kan kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze , per te cilat te akuzuarit ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhne ne perfundim, se pranimi i fajesis nga ana e te akuzareve eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzareve formohen te gjitha elementet e vepres penale lendim i lehte trupor nga neni 185 par.2 te KP-es dhe vepra penale kanosje nga neni 181 par.4 te KP-es, dhe per kete gjykata te akuzuarit i shpalli fajtorë dhe i shqiptoi denimin gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tyre penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat renduese dhe lehtesuese ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos gjetur si rrethana posaquerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesis nga ana e te akuzareve, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tyre, si dhe ne kuptim te nenit 69,70, 71 e 72 gjykata morri per baze edhe faktin se te akuzuarit kane bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tyre ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, qe nga ajo dite e deri me sot nuk kane perseritur veper penale, i premtojne gjykates se ne te ardhmen nuk do te perserisin edhe njehere keso lloj te vepres penale, publikisht i kerkojne falje te demtuareve dhe me te njejtit deshirojne qe ta gjejne gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, jane te pa pune, relativisht te ri ne moshe, te gjendjes se dobet ekonomike, gjer me tani te pa gjykuar, çka nenkupton se nuk kane ardhur ndesh me rregullat pozitive, si rrethane posaquerisht lehtesuese per te akuzuarit eshte marr pranimi i fajesis, andaj gjykata me aplikimin e nenit 44 dhe 71 par.1 p.1.2 te KP-es, te Kosoves, me pelqimin e te akuzareve denimin me burgim, i ka zevendesuar ne denim me gjobe, dhe i ka shqiptuar denimin me gjobe si te merituar, si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tyre dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jene te kujdesshem dhe do te permbahen nga veprimet e tilla te karakterit juridiko-penal.

Vendimin mbi kerkesen pasuroro-juridike gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 463 te KPPK-se

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 1/20 të datës 10.06.2020

Sekretare Juridike

Gjyqtari

Numri i lëndës: 2019:278755
Datë: 12.06.2020
Numri i dokumentit: 00960622

Fatime Bajraktari

Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.